



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.447/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e evidentuar si Anr.447/2021, e të datës 14.02.2021, e paraqitur nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i Shqiptohet gjobë, në lartësi prej 1,500 (njëmijë e pesëqind) euro, dhe detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.447/2021, nga subjekti politik LVV, e paraqitur kundër subjektit politik LDK, në të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve më datë 14.02.2021 në afërsi të Gjimnazit “Jeta e Re”, në qytetin e Therandës, simpatizantët e subjektit politik LDK-së, kanë vendosur një billboard me përmbajtje elektorale të kandidatëve për deputet nga subjekti politik LDK.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar në cilësi të provës materiale.

Në përgjigjet në ankesë subjekti politik LDK, thekson se ankesa e subjektit politik LVV, është e pabazuar nga ngase billboardi i vendosur në qytetin e Suharekës, siç shihet në fotografinë e bashkangjitur si provë, e njëjta posedon kontratë me kompaninë e cila është e angazhuar për çështje të tilla, dhe se hapsira ku është i vendosur billboardi i dedikohet reklamimeve, andaj asgjë nuk është në kundërshtim me pretendimet ankimore të LVV-së.

Subjekti politik LDK, kërkon nga PZAP-i që ankesa e paraqitur nga subjekti politik LVV, të hudhet poshtë si e pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet qartë se në ditën e zgjedhjeve më datë 14.02.2021, në afërsi të Gjimnazit “Jeta e Re”, në qytetin e Therandës, simpatizantët e subjektit politik LDK-së, kanë vendosur një billboard me përmbajtje elektorale të kandidatëve për deputet nga subjekti politik LDK, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b, të LZP-së, me të cilin ka bërë promovimin e subjektit politik LDK dhe kandidatëve për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj PZAP, duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se LDK, është përgjegjëse për veprimet e tyre, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36, paragrafi 1, pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se kemi të bëjmë me numrin e shkeljeve të përsëritura,
- Faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba LDK ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme,
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet që bien ndesh me rregullativën ligjore, që te mos cenohet heshtja zgjedhore duke siguruar klimë të qetë dhe të përshtatshme për votim të lirë si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.447/2021 më datë 15.02.2021

Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.